



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
PËRMBAJTJEN E MATERIALEVE PROMOVUESE PËR FONDIN E PENSIONIT
PRIVAT DHE SHOQËRINË ADMINISTRUESE

Miratuar me Vendim Bordi nr. 141, datë 28.08.2024

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e përmbajtjes, format e reklamimit, ndryshimet dhe ruajtjen e materialeve promovuese për fondin e pensionit privat dhe shoqërinë administruese.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 83, pika 3, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

Neni 3
Përkufizime

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, këtu e në vijim “Ligji”.

Neni 4
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga shoqëria administruese e licencuar për çdo material promovues për të dhe për fondin e pensionit privat të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 5
Njoftimi i materialit promovues

1. Çdo material promovues i shoqërisë administruese së fondit të pensionit privat për promovimin e fondit të pensionit privat apo promovimin e shoqërisë administruese dhe i miratuar nga personi kyç i shoqërisë, njoftohet në Autoritet përpara botimit, publikimit apo dorëzimit tek publiku nëpërmjet medias së shtypur dhe/ose elektronike.
2. Shoqëria administruese, bashkë me njoftimin depoziton me shkresë në Autoritet çdo material promovues në formë të shkruar ose në formë elektronike, i cili do të përdoret për veprimtarinë promovuese.

Neni 6
Procedura e shqyrtimit të materialit promovues në Autoritet

1. Autoriteti, shqyrton materialet promovuese për fondin e pensionit dhe shoqërinë administruese, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të tyre sipas nenit 5, të kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti, në përfundim të shqyrtimit, vetëm në rastet kur konstaton se nuk janë respektuar parashikimet e Kreut IV, të ligjit dhe kësaj rregulloreje, i kërkon shoqërisë administruese të:
 - a. ndalojë menjëherë publikimin, shpërndarjen apo botimin e materialit promovues;
 - b. korrigjojë materialin promovues duke u shprehur për ndryshime apo përfshirjen e informacioneve shtesë.
3. Materiali i korrigjuar sipas kërkesës së Autoritetit duhet të depozitohet sërish në Autoritet për rishqyrtim.
4. Në çdo rast, gjykimi i Autoritetit rreth materialeve promovuese nuk mund të përdoret për qëllime promovuese.
5. Gjatë periudhës së shqyrtimit sipas parashikimeve të këtij neni, shoqëria administruese nuk mund të vijojë me materialin promovues.

Neni 7
Ndryshimi i materialeve promovuese

1. Shoqëria administruese njofton me shkresë Autoritetin për çdo ndryshim të materialeve promovuese përpara botimit, publikimit apo dorëzimit tek publiku.
2. Dispozitat e Kreut IV, të ligjit, si dhe të kësaj rregulloreje zbatohen për shoqërinë administruese dhe fondin e pensionit privat edhe në rastin e ndryshimeve të materialeve promovuese.

Neni 8
Përmbajtja e materialeve promovuese

1. Përveç sa parashikohet në Kreun IV, të ligjit, materialet me përmbajtje promovuese duhet:
 - a. të jenë të qarta, të sakta, të vërteta, të përditësuara që nuk çojnë në përfundime të gabuara dhe janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit dhe ligjit;
 - b. të jenë në gjuhën shqipe. Nëse materialet promovuese paraqiten edhe në gjuhë të huaj përveç gjuhës shqipe, duhet të përmbajnë shënimin: *“Në rast të paqartësive apo keqinterpretimeve*

- prevalon materiali në gjuhën shqipe”.*
- c. të formulohen në mënyrë të tillë që të mos keqinformojnë apo mashtrojnë anëtarët aktualë ose anëtarët e mundshëm të fondit;
 - ç. të paraqesin një përshkrim të saktë dhe të vërtetë të shoqërisë administruese apo fondit të pensionit që po promovohet si dhe i të drejtave/përfitimeve dhe detyrimeve apo rreziqeve që lidhen me të;
 - d. gjuha duhet të jetë e qartë dhe e drejtpërdrejtë, duke mos lënë vend për keqinterpretime.
2. Materialet promovuese duhet të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a. emrin e plotë të shoqërisë administruese/të fondit të pensionit si dhe monedhën bazë të fondit;
 - b. adresën, faqen zyrtare të internetit, numrin e telefonit si dhe të dhëna të tjera që çojnë në identifikimin e tyre.
 3. Çdo referencë për performancën e kaluar të fondit të pensionit duhet të përmbajë domosdoshmërisht shprehjen e mëposhtme: *“Performanca e kaluar nuk është garanci për arritjet e ardhshme”.*
 4. Materialet promovuese nuk duhet të referojnë emrin e Autoritetit për qëllime promovuese.

Neni 9

Forma e reklamimit

1. Veprimtaria promovuese e fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese reklamohet nëpërmjet medias së shtypur dhe elektronike.
2. Veprimtaria promovuese përfshin por nuk kufizohet në:
 - a. broshura;
 - b. reklama në shtypin e ditës, revista, radio, televizione dhe faqe interneti;
 - c. materiale promovuese të dërguara me postë të zakonshme ose elektronike, faks ose mjete të tjera;
 - ç. telemarketing, i cili përfshin përdorimin e një ofruesi të specializuar të shërbimit telemarketing, në bazë të një kontrate të lidhur me shoqërinë administruese;
 - d. materiale ose mjete të tjera promovimi mund të lexohen, shihen ose të dorëzohen te publiku.
3. Në materialin promovues në formë të shtypur, të gjitha informacionet duhet të shkruhen në mënyrë të tillë që mesazhi të jetë i lexueshëm dhe i kuptueshëm. Madhësia e tekstit duhet të jetë e tillë që të mund të lexohet lehtësisht.
4. Në materialin promovues të transmetuar me mjete audio, i gjithë informacioni do të paraqitet me të njëjtën shpejtësi dhe volum zëri.

Neni 10

Ndalimi i materialeve promovuese

1. Autoriteti ndalon materialet promovuese nëse përmbajnë:
 - a. vlerësime ose parashikime në lidhje me ecurinë e ardhshme të fondit të pensionit ose të shoqërisë administruese;
 - b. krahasime ndërmjet fondeve të ndryshme të pensioneve ose ndërmjet shoqërive administruese të ndryshme që vënë në disavantazh shoqëri administruese ose fonde pensioni të tjera;

- c. togfjalëshin “rezultat i garantuar”, “përfitim i garantuar”, “pension i garantuar”, “skema më e mirë e pensioneve” ose çdo formulim tjetër që mund të krijojë përshtypjen për një fitim të sigurt;
 - ç. deklarata nga persona që nuk janë anëtarë të fondit.
2. Në çdo rast, shoqëria administruese ndalohe të fillojë promovimin e një fondi të ri para se ky të miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 11

Miratimi i materialeve promovuese nga shoqëria administruese

Shoqëria administruese e licencuar nga Autoriteti ngarkon një person kyç për të miratuar të gjitha veprimtaritë dhe materialet me përmbajtje promovuese për të dhe në emër të saj.

Neni 12

Ruajtja e materialeve promovuese

1. Shoqëria administruese është e detyruar të ruajë një kopje të materialeve promovuese, sipas afateve kohore që parashikohen në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.
2. Shoqëria administruese ruan të dhënat për të gjitha materialet promovuese duke përfshirë:
 - a. një dokument në format elektronik të miratuar/ nënshkruar nga njësia përgjegjëse/ personi kyç i shoqërisë;
 - b. datën e miratimit të materialit promovues;
 - c. vendin ku është publikuar materiali promovues.
3. Këto të dhëna i vihen në dispozicion Autoritetit në çdo inspektim të mundshëm.

Neni 13

Masat administrative

Shkelja e detyrimeve të parashikuara në këtë rregullore është objekt i sanksioneve sipas parashikimeve të nenit 199, të ligjit.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.